



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



21-08-2026
07-353/02-129154/26
NR. BR.

Drejtoria e Shërbime Publike – Komuna e Prishtinës

Në mbështetje të nenit 7, (paragrafi 2), në përputhje me nenin 8, (paragrafi 2), nenin 14, (paragrafi 1) lidhur me nenin 4 (paragrafi 2, pika a dhe b) të *Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike* (01. nr. 110-157481, datë 01.07.2014), Drejtoria për Shërbime Publike njofton si vijon:

THIRRJE

**Për pajisjen me leje për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve
(vendosja e objekteve të përkohshme)**

Të gjitha lokalet (bizneset) që shfrytëzojnë ose kërkojnë të shfrytëzojnë hapësira publike para lokaleve për vendosjen e objekteve të përkohshme, përkatësisht tavolinave gjatë sezonit veror, si dhe tavolinave me rrethojë gjatë sezonit veror/dimëror, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2, pikat a dhe b të *Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike* (në tekstin e më tejme: *Rregullorja*), ftohen t'i nënshtrohen procedurës për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike para lokalit.

1. Dokumentet e nevojshme që duhet ti bashkëngjiten kërkesës

Në përputhje me nenin 8, paragrafi 2 të *Rregullores*, kërkesës i bashkëngjiten:

1.1. Për tavolinat para lokaleve gjatë sezonit veror:

- projekti me dimensionet e hapësirës,
- certifikata e biznesit,
- foto,
- skica e lokacionit dhe
- kopja e dokumentit të identifikimit.
- Kontrata për hedhjen e mbeturinave me "KRM Pastrimi SH.A"

2. Procedura, leja dhe pagesa

- Dhënia në shfrytëzim e hapësirës publike për këto objekte bëhet me dhënie të drejtpërdrejtë nga organi kompetent për administrimin e sipërfaqeve publike (neni 14, paragrafi 1 të *rregullores*).
- Vendimi për lejim lëshohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e ushtrimit të kërkesës, nëse plotësohen kushtet e parapara me nenin 9 të *Rregullores*.

- Leja lëshohet më së largu deri në përfundim të vitit kalendarik siç përcaktohet në nenin 10 të rregullores.
- Për shfrytëzimin e hapësirës publike para lokalit paguhet taksë mujore sipas zonave, e përcaktuar në nenin 2, pika 6.9 të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale (Shfrytëzimi i hapësirës para objektit në të cilin kryhen shërbimet tregtare dhe hoteliere), si vijon:
Zona I — 8 €/m²;
Zona II — 6 €/m²;
Zona III — 4 €/m²;
Zona IV — 3 €/m² (taksë mujore).
- Mospagesa e taksës për shfrytëzim brenda afateve të caktuara mund të sjellë tërheqjen e lejes para skadimit të afatit (neni 12, paragrafi 3, pika c e rregullores).

3. Obligimet e shfrytëzuesit

- Të mirëmbajë hapësirën përreth sipas (nenit 20);
- Të mos krijojë pengesa në lëvizjen e lirë në trotuare dhe hapësira publike, si dhe të mos rrezikojë sigurinë dhe dukshmërinë në komunikacion (nenet 3 dhe 6, paragrafi 3).

4. Pasojat e mospërbushjes

Bizneset të cilat, pas datës 4 shtator 2026, nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, do t'u nënshtrohen masave ligjore nga Inspeksioni komunal, përkatësisht:

- Heqjes (largimit/demolimit) së objektit me vendim, pa të drejtë kompensimi dhe në shpenzime të shfrytëzuesit (nenet 21 dhe 11, paragrafi 2);
- Gjohës në vlerë prej 450 € deri 750 € për personin fizik ose juridik që vepron në kundërshtim me Rregulloren (neni 22).

5. Vendi dhe afati i aplikimit

Aplikimet dorëzohen në Sportelet e Qendrës për Shërbim me Qytetarë për **Drejtorinë e Shërbime Publike** në objektin e vjetër të Komunës, ose në formë digjitale përmes platformës <https://aplikimet.prishtinaonline.com> më së largu deri më **07/09/2026, në ora 16:00**.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren në shqyrtim.

Drejtoria e Shërbime Publike

